

**LIGJI Nr. 04/L-084
PËR PENSIONET E PJESËTARËVE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR PENSIONET E PJESËTARËVE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj përcakton të drejtën në pension për pjesëtarin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe familjarët e tij.

**Neni 2
Fusha e zbatimit**

Ky ligj rregullon dhe përcakton kushtet, kriteret për garantimin e pensioneve dhe llojet e pensioneve për pjesëtarin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe familjarët e tij.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1.**Departamenti i Administratës Pensionale (DAP)** - Njësia administrative në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;

1.2.**Familjarët** - Siç parashihet në nenin 12 të këtij ligji;

1.3.**FSK** - Forca e Sigurisë së Kosovës;

1.4.**Koha e shërbimit** - E gjithë periudha kohore e shërbimit, si pjesëtar i FSK-së. Koha e shërbimit llogaritet me ditë, muaj dhe vite dhe nuk përfshinë pushimet e pa autorizuara;

1.5.**MFSK** - Ministria përkatëse për Forcën e Sigurisë së Kosovës;

1.6.**MPMS** - Ministria përkatëse e Punës dhe Mirëqenies Sociale;

1.7.**Pension** - Pagesa e rregullt mujore të financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për pensionistin që i plotëson kushtet e parapara me këtë ligj;

1.8.**Pensioni Familjar** - Pensioni i rregullt mujor për familjarët në rast të vdekjes së pjesëtarit/pensionistit të FSK-së, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj;

1.9.**Pensioni i FSK-së** - Pensioni i pjesëtarit të FSK-së;

1.10. **Pensionin i pjesëtarit aktiv të FSK-së** - Pagesa e rregullt mujore që paguhet nga Buxheti i Kosovës për pjesëtarin aktiv të FSK-së, i cili i plotëson kriteret e parapara me këtë ligj për pensionim;

1.11. **Pensionin i pjesëtarit Rezervë të FSK-së** - Pagesa e rregullt mujore që paguhet nga Buxheti i Kosovës për pjesëtarin rezervë të FSK-së, i cili i plotëson kriteret e parapara me këtë ligj për pensionim;

1.12. **Pensionisti i FSK-së** - Personi, të cilit i takon e drejta në pension të FSK-së;

1.13. **Pjesëtar Aktiv i FSK-së** - Pjesëtar i cili shërben me orar të plotë në FSK-ë;

1.14. **Pjesëtar i FSK-së** - Pjesëtar aktiv (përfshirë rekrutët dhe kadetët) dhe pjesëtar rezervë i FSK-së;

1.15. **Pjesëtar rezervë i FSK-së** - Sipas Ligjit të Komponentit Rezervë;

1.16. **Rezerva e FSK-së** - Komponenti Rezervë i FSK-së;

1.17. **TMK** - Trupat e Mbrojtjes së Kosovës.

Neni 4 Llojet e pensioneve

1. Ky ligj rregullon këto lloje të pensioneve:

1.1. Pensionin e rregullt;

1.2. Pensionin invalidor;

1.3. Pensionin familjar.

Neni 5 Përfituesit

1. Përfituesit e pensioneve të përcaktuara me këtë ligj janë:

1.1. pjesëtar aktiv i FSK-së, i cili përmbush kriteret e parapara në nenin 6 të këtij ligji;

1.2. pjesëtar i Rezervës së FSK-së, i cili përmbush kriteret e parapara në nenin 9 të këtij ligji;

1.3. familjarët, të cilët i përmbushin kriteret e parapara në nenet 13, 16 dhe 19 të këtij ligji.

2. Përfituesit kanë të drejtë në pensionin e FSK-së, pavarësisht nga një punësim tjetër në sektorin publik apo privat, përveç nëse ata shërbejnë sërish në FSK.

3. Përfituesit që kanë të drejtë në pensionin e FSK-së, të paraparë me këtë ligj, duhet të zgjedhin njërin nga përfitimet: pensionin që iu takon me këtë ligj, apo përfitimet tjera që parashihen me ligjet tjera në fuqi.

Neni 6 Pensionin për pjesëtarin aktiv të FSK-së

1. Pjesëtar aktiv i FSK-së fiton të drejtën në pension të rregullt, nëse koha e tij e shërbimit, si pjesëtar aktiv i FSK-së, është së paku njëzet (20) vite dhe ka mbushur moshën pesëdhjetë (50) vjeçare si nënoficer dhe pesëdhjetë e pesë (55) vjeçare si oficer.

2. Pjesëtari aktiv i FSK-së fiton të drejtën në pension invalidor, nëse, të njëjtit, i ndërpritet shërbimi për shkak të lëndimeve ose sëmundjeve profesionale. Shkalla e invaliditetit përcaktohet nga Komisioni mjekësor që vepron në kuadër të MPMS-së, sipas rekomandimeve të Bordit mjekësor të FSK-së.

3. Kriteret dhe procedurat për përcaktimin e shkallës së invaliditetit përcaktohen me akt nënligjor, të cilin e nxjerrë MFSK dhe MPMS.

Neni 7

Lartësia e pensioneve të pjesëtarit aktiv të FSK-së

1. Lartësia e pensionit të rregullt të pjesëtarit aktiv të FSK-së llogaritet në bazë të përqindjes së pagës bruto të pjesëtarit dhe kohës së shërbimit. Paga bazohet në gradën e pjesëtarit të FSK-së, në momentin e pensionimit.

2. Baza e pensionit të rregullt të pjesëtarit aktiv të FSK-së është dyzet përqind (40%) e pagës bruto së pjesëtarit të FSK-së në momentin e pensionimit. Për çdo vit shërbimi si pjesëtar aktiv i FSK, koeficienti i përqindjes rritet për dy përqind (2%), por nuk mund të kaloj gjashtëdhjetë përqind (60%) e pagës bruto.

3. Lartësia e pensionit invalidor të pjesëtarit të FSK-së llogaritet varësisht nga shkalla e paaftësisë së përhershme për punë të fituar në shërbim. Pjesëtari aktiv realizon pensionin invalidor nga njëzet deri njëqind përqind (20-100%) të pagës bruto, në momentin e invaliditetit. Për çdo vit të shërbimit, si pjesëtar aktiv i FSK-së, pagesa financiare rritet për dy përqind (2%) në koeficientin e përqindjes, por nuk mund ta kaloj njëqind përqind (100%) të pagës bruto.

Neni 8

Humbja e së drejtës në pensionin e pjesëtarit aktiv të FSK-së

1. Shfrytëzuesi e humb të drejtën e pensionit të pjesëtarit aktiv të FSK-së:

1.1. në rast të vdekjes;

1.2. nëse vlerësohet se parashtruesi i kërkesës ka bërë mashtrim gjatë procesit të aplikimit;

1.3. nëse gjatë monitorimit dhe inspektimit nga zyrtarët përgjegjës të DAP-it, konstatohen prova materiale të rrejshme nga ana e pensionistit.

Neni 9

Pensioni për pjesëtarin rezervë të FSK-së

1. Pjesëtari rezervë i FSK-së fiton të drejtën në pension të rregullt të FSK-së, nëse koha e tij e shërbimit, si pjesëtar rezervë i FSK-së, është së paku njëzet (20) vite dhe ka mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare. Ky pension i takon pjesëtarit rezervë të FSK-së, si shtesë e pensionit bazik.

2. Pjesëtari rezervë i FSK-së fiton të drejtën në pension invalidor, nëse, të njëjtit, i ndërpritet shërbimi për shkak të lëndimeve ose sëmundjeve profesionale. Shkalla e invaliditetit përcaktohet nga Komisioni mjekësor që vepron në kuadër të MPMS, sipas rekomandimeve të Bordit mjekësor të FSK-së.

Neni 10

Lartësia e pensionit të pjesëtarëve rezervë të FSK-së

1. Lartësia e pensionit të rregullt të pjesëtarit rezervë të FSK-së, llogaritet në bazë të përqindjes së pagës bruto të pjesëtarit dhe kohës së shërbimit.

2. Përqindja e pensionit llogaritet nga zero pikë pesë përqind (0.5%) për çdo vit të shërbimit në FSK, bazuar në gradën që bart pjesëtari në momentin e pensionimit.

3. Lartësia e pensionit invalidor të pjesëtarit rezervë të FSK-së llogaritet varësisht nga shkalla e paaftësisë për punë. Pjesëtari rezervë realizon pensionin invalidor nga njëzet deri njëqind përqind (20-100%) të pagës bruto. Për çdo vit të shërbimit si pjesëtar rezervë i FSK-së, pagesa financiare rritet për zero pikë pesë përqind (0.5%), por nuk mund ta kalojë njëqind përqind (100%) të pagës bruto.

Neni 11

Humbja e së drejtës në pensionin e pjesëtarit rezervë të FSK-së

Shfrytëzuesi e humb të drejtën në pensionin e pjesëtarit rezervë të FSK-së, sipas kushteve të parapara me nenin 8 të këtij ligji.

Neni 12

E drejta në pension familjar

1. E drejta në pensionin familjar u takon:

1.1. bashkëshort/it-ës;

1.2. fëmijëve trashëgimtarë, duke përfshirë fëmijët martesor, jashtëmartesor dhe të adoptuar;

1.3. prindërve.

Neni 13

E drejta e bashkëshortit/ës në pension familjar

Personi, i cili është në martesë me pjesëtarin/pensionistin e FSK-së në kohën e vdekjes së tij, ka të drejtë të marrë pensionin e bashkëshortit/it-ës, pavarësisht moshës.

Neni 14

Lartësia e pensionit të bashkëshortit/it-ës në pension familjar

Lartësia e pensionit të bashkëshortit/it-ës është gjashtëdhjetë (60) përqind e pensionit që i është paguar pjesëtarit/pensionistit që ka vdekur.

Neni 15

Humbja e së drejtës së bashkëshortit/it-ës në pensionin familjar

1. Shfrytëzuesi e humb të drejtën e tij/saj në pensionin familjar:

1.1. në rast të vdekjes;

1.2. në rast të martesës së re;

1.3. me vendimin e gjykatës për humbjen e kujdesit të fëmijëve trashëgimtarë.

Neni 16

E drejta e fëmijëve trashëgimtarë në pension familjar

1. Fëmijët trashëgimtarë të pjesëtarit/pensionistit të FSK-së, të cilët janë nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, përkatësisht moshën njëzet e gjashtë (26) vjeçare, nëse ofrojnë dëshmi për vijueshmërinë e shkollimit, kanë të drejtë në pensionin familjar pas vdekjes së pensionistit.

2. Fëmijët trashëgimtarë me aftësi të kufizuara, të pjesëtarit/pensionistit të FSK-së, kanë të drejtë në pension familjar pavarësisht nga mosha, nëse ata janë me aftësi të kufizuara në datën e vdekjes së pensionistit, në masën e njëjtë sikurse për fëmijët tjerë, për gjithë jetën.

Neni 17
Lartësia e pensionit familjar të fëmijëve

1. Lartësia e pensionit familjar për secilin fëmijë është dhjetë përqind (10%), por nuk mund ta kalojë dyzet përqind (40%) të pensionit të pjesëtarit/pensionistit të vdekur. Nëse ka më shumë fëmijë ndahet në mënyrë të barabartë.

2. Nëse bashkëshorti/ja humb të drejtën në pension, ose nëse pjesëtari/pensionisti i FSK-së nuk ka bashkëshort/e, atëherë pensioni i fëmijëve trashëgimtarë rritet për gjashtëdhjetë përqind (60%) dhe ndahet në mënyrë të barabartë për të gjithë.

Neni 18
Humbja e drejtës së fëmijëve në pensionin familjar

1. Fëmija trashëgimtar e humb të drejtën e tij/saj për pension familjar në rast të:

1.1. vdekjes së shfrytëzuesit;

1.2. me arritjen e moshës tetëmbëdhjetë (18) vjeçare apo me përfundimin ose ndërprerjen e shkollimit ose arritjen e moshës njëzet e gjashtë (26) vjeçare;

1.3. shërimit nga paaftësia/invaliditeti.

Neni 19
E drejta e prindërve në pensionin familjar

Në rastet kur pjesëtari/pensionisti i FSK-së nuk ka bashkëshort/e dhe fëmijë, pensioni familjar iu takon njërit prej prindërve të pensionistit, në lartësinë prej gjashtëdhjetë përqind (60%) të pensionit të pensionistit të vdekur të FSK-së.

Neni 20
Rregullat e veçanta të përfitimit të pensionit familjar

Në rastet kur pjesëtari i FSK-së vdes në detyrë ose për shkak të detyrës, ashtu siç e përcakton Komisioni i veçantë i MFSK-së, familjarëve të tij/saj, të përcaktuar me këtë ligj, iu takon pension ashtu siç parashihet në nenin 13, 16, dhe 19, të këtij ligji duke llogaritur pensionin mbi bazën njëqind përqind (100%) të pagës së pjesëtarit.

Neni 21
Realizimi i pensionit familjar

Shfrytëzuesit e pensionit familjar, të paraparë me këtë ligj, duhet të zgjedhin njërin nga pensionet: atë, të cilin e trashëgojnë nga pensionisti i FSK-së, apo pensionet të tjera, që përcaktohen me skemat tjera pensionale.

Neni 22
**Rregullat e veçanta të pensionimit
për ish-pjesëtarin e TMK-së, të cilët shërbejnë në FSK**

1. Pjesëtari aktiv i FSK-së, i cili ka shërbyer në TMK e fiton të drejtën në pension të rregullt të FSK-së:

1.1. pasi të ketë përmbushur shërbimin tre (3) vjeçar në FSK dhe me Vendim të Ministrit të FSK-së të bazuar në kriteret e akteve të brendshme të shërbimit në FSK, si dhe në pajtim me mundësitë vjetore financiare të Buxhetit të Republikës së Kosovës; ose

1.2. me arritjen e moshës pesëdhjetë (50) vjeçare si nënoficer dhe pesëdhjetë e pesë (55) vjeçare si oficer.

2. Nëse për çfarëdo arsye tejkalohej numri i parashikuar për pensionimin e pjesëtarëve të FSK, për secilin vit kalendarik, sipas Vlerësimit Financiar të paraparë nga MFSK, duhet të nxirret vendim i veçantë i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

3. Shuma e pensionit të rregullt llogaritet mbi pagën bazë të pjesëtarit në momentin e pensionimit. Përqindja e pensionit të rregullt është dyzet përqind (40%) e pagës bazë bruto, dhe për çdo vit të shërbimit si pjesëtarë i FSK-së dhe TMK-së koeficienti i përqindjes rritet për dy përqind (2%) por nuk mund ta kalojë gjashtëdhjetë përqind (60%) e pagës bazë.

4. Pjesëtarët të cilët pensionohen sipas nën-paragrafit 1.1 të paragrafit 1. të këtij neni, do të marrin pensionin mbi bazën dyzet përqind (40%), ndërsa llogaritja e viteve të shërbimit për dy përqind (2%) do të bëhet pas arritjes së moshës pesëdhjetë (50) vjeçare për nënoficer dhe pesëdhjetë e pesë (55) vjeçare për oficer.

5. Pjesëtarë i FSK-së, i cili ka shërbyer në TMK e fiton të drejtën në pension invalidor, nëse, të njëjtit, i ndërpritet shërbimi për shkak të lëndimeve ose sëmundjeve profesionale. Shkalla e invaliditetit përcaktohet nga Komisioni mjekësor që vepron në kuadër të MPMS-së, sipas rekomandimeve të Bordit mjekësor të FSK-së.

6. Lartësia e pensionit invalidor të pjesëtarit aktiv të FSK-së, i cili ka shërbyer në TMK, llogaritet varësisht nga shkalla e paaftësisë për punë. Pjesëtarë realizon pensionin invalidor nga njëzet deri njëqind përqind (20-100 %), të pagës bruto, për çdo vit të shërbimit, si pjesëtarë aktiv i FSK-së, duke përfshirë edhe vitet e shërbimit në TMK, koeficienti i përqindjes rritet për dy përqind (2%), por nuk mund ta kalojë njëqind përqind (100%) të shumës totale.

Neni 23

Obligimet ligjore të shfrytëzuesve të pensioneve

1. Të gjithë shfrytëzuesit e pensioneve të parapara me këtë ligj, janë të obliguar të njoftojnë me shkrim administratën pensionale të Kosovës për çdo ndryshim të rrethanave.

2. Mos përmbushja e obligimeve nga paragrafi 1. i këtij neni sanksionohet sipas ligjit në fuqi.

Neni 24

Menaxhimi dhe Administrimi i Pensioneve

DAP, si njësi e MPMS, menaxhon dhe administron pagesën e pensioneve të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 25

Indeksi i Pensioneve

Pensionet që rregullohen me këtë ligj indeksohen sipas kushteve dhe kriterëve të cilat aplikohen për indeksimin e skemave tjera pensionale të financuara nga shteti.

Neni 26

Sigurimi i mjeteve financiare për pensione

Mjetet financiare për pagesën e të gjitha pensioneve të përcaktuara me këtë ligj, do të sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Neni 27
Garantimi i pensioneve

Qeveria e Republikës së Kosovës do të garantojë realizimin e të drejtave për të gjitha llojet e pensioneve të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 28
Procedurat Administrative

Pensionet e përcaktuara me këtë ligj realizohen sipas procedurave të parapara për skemat tjera pensionale të financuara nga shteti, duke përfshirë edhe procedurat e ankimit, sipas ligjit në fuqi për procedurat administrative.

Neni 29
Pensionet e FSK-së para hyrjes në fuqi të këtij ligji

Pjesëtari i FSK-së dhe familjarët e tyre kanë të drejtë në pensionet e parapara me këtë ligj, nëse këto të drejta janë fituar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 30
Aktet nënligjore

Të gjitha aktet nënligjore, të parapara me këtë ligj, përgatiten dhe miratohen nga institucionet përkatëse, në afat prej gjashtë (6) muajve, prej ditës kur ky ligj hyn në fuqi.

Neni 31
Hyrja në Fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-084
15 mars 2012

Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.